



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E VERIFIKIMIT**

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 37, datë 15.05.2018

Agjencia e Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (në vijim “LPP”), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik “Çaushi” Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):

“Çaushi” Shpk me NIPT J 97511807 W me adresë: Rruga “Jorgjia Turja”, Kompleksi IKEA, pranë Qytetit Studenti, Tiranë.

II. Arsye e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik “Çaushi” Shpk ka nisur mbi bazën e kërkesës së autoritetit kontraktor Ujësjetllës-Kanalizime Durrës Sha, ku është kërkuar përjashtimi i këtij operatori ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

III. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se nuk ndodheshim në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore, sipas parashikimeve të nenit 13/3/ç të LPP.

IV. Masat:

Me Vendimin Nr. 37, datë 15.05.2018 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të mos përjashtojë operatorin ekonomik “Çaushi” Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, mbështetur në vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila ka vlerësuar se, mospërmbushja e detyrimeve ka ardhur si pasojë e veprimeve të autoritetit kontraktor.